



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. _____
Nr. Dok. 202300426/2

Tiranë ___/___/2023

Lënda: *Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të të dënuarve dhe të paraburgosurve në IEVP Fier.*

Drejtuar: Z. Admir ABRIJA
Drejtore i Përgjithshëm i Burgjeve

TIRANË

Z. Ervin BUSHI
Drejtore i IEVP-së Fier

FIER

I nderuar z. Abrija,

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruar, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) në Fier.

Inspektimi u krye më datë 09.05.2023, sipas planit të miratuar nga Avokati i Popullit. Grupi i inspektimit përbëhej nga z. Besnik Deda, znj. Gloria Çarkaxhiu, z. Hazbi Selita, znj. Nertila Qafzezi dhe znj. Lindita Dedegjoni, me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Qëllimi i vizitës inspektuese në IEVP Fier, ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave të të burgosurve, të cilat u garantohen nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, legjislacioni kombëtar dhe ai ndërkombëtar për të drejtat themelore të të burgosurve, si dhe plotësimi i kushteve materiale për jetesë e aktivitete rehabilituese për të burgosurit.

Objekt i inspektimit, ishte edhe verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të MKPT-së nga inspektimi i mëparshëm, dërguar përmes raportit në datë 22.12.2022¹.

Vizita inspektuese u zhvillua në një frymë të mirë bashkëpunimi me stafin civil dhe punonjësit e policisë të IEVP-së Fier. Ekipit të MKPT-së, iu krijuan kushte dhe mundësi për të vizituar ambientet e përbashkëta të shërbimeve për të burgosurit, dhomat e banimit, vendet e takimeve me familjarët, kuzhinën, spitalin, si dhe ambientet e ajrimit në regjimin e brendshëm. U zhvilluan intervista konfidenciale me të burgosurit, pa praninë e stafit të institucionit dhe në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

Në përfundim, grupi i inspektimit pasi u njoh me dokumentacionin sipas sektorëve, administroi kopje të praktikave të punës, ku pasqyrohej programi ditor, aktivitetet dhe veprimtaritë që zhvillohen me të paraburgosurit dhe më vehte për të dënuarit.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit të inspektimit, ka detyrimin ligjor t'ju parashtojë gjetjet e këtij inspektimi me rekomandimet përkatëse, si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Inspektimi në IEVP Fier, u krye në kuadër të monitorimit që Avokati i Popullit nëpërmjet MKPT, zhvillon periodikisht në institucionet ku privohet liria e personit. Bazuar në metodologjinë e inspektimit në burgje, grupi i inspektimit u takua me drejtorin e institucionit z.Ervin Bushi, zv/drejtorin e IEVP-së, shefin e policisë, si dhe përgjegjësat e sektorëve juridik, të çështjeve shoqërore, logjistikës dhe të burimeve njerëzore, të cilët u vunë në dijeni të qëllimit të inspektimit.

Drejtuesit dhe stafi i institucionit informuan grupin e MKPT-së, lidhur me masat e marra në kuadër të respektimit të të drejtave të të burgosurve që vuajnë dënimin në këtë institucion, zhvillimin e aktiviteteve në regjimin e brendshëm, gjendjen e kushteve materiale për jetesë për të burgosurit, funksionimi i sistemit të kërkesë/ankesave të të burgosurve, trajtimi dhe zgjidhja e tyre, shërbimi shëndetësor, si dhe ofrimi i një sërë shërbimesh të tjera ndihmëse.

Sipas informacionit, IEVP Fier bazuar në urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr.381, datë 19.07.2019 "Për disa ndryshime në urdhrin nr.8927/1, datë 27.09.2018 të Ministrit të Drejtësisë "Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale", kategorizohet: "*burg i sigurisë së zakonshme me një seksion paraburgimi, një seksion për të dënuarit dhe një seksion për personat që konsiderohen "Bashkëpunor të Mbrojtur të Drejtësisë"*".

Struktura organike e IEVP-së Fier, është e miratuar me Urdhër të Kryeministrit të RSH nr.43, datë 25.03.2021 "*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe sistemit të institucioneve të varësisë së saj*". Organika e

¹Me shkresë nr.K4/187-2 prot., datë 22.12.2022 dërgohet "Rekomandim për përmirësimin e kushteve dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve në IEVP Fier".

institucionit përbëhet nga 395 punonjës, nga të cilët 59 punonjës civil dhe 336 punonjës të policisë së burgjeve. Nga informacioni, mungesat në organikën e institucionit, rezultojnë si më poshtë vijon:

- në stafin civil 5 vende vakande: 1 mjek i përgjithshëm, 1 punonjës edukimi, 2 infermier dhe 1 mirëmbajtës.
- në stafin e policisë 56 vende vakante, kryesisht punonjës policie të rolit bazë.

Mungesat në stafin civil dhe atë të policisë, ndikonin pjesërisht në plotësimin e të drejtave dhe ofrimin e shërbimeve për të dënuarit dhe të paraburgosurit. Sipas informacionit të drejtuesve të institucionit, vendet vakante në stafin e policisë, sektorin e shëndetësisë dhe të edukimit, do të plotësohen së shpejti, pasi propozimet për specialistët sipas fushave, ishin dërguar pranë DPB-së².

IEVP Fier ka një kapacitet për akomodimin e 850 personave, referuar numrit të dhomave dhe të shtretërve në a) godinat e banimit, b) sektorin e veçimit dhe të observimit, c) sektorin e kujdesit të veçantë (SKV), d) sektorin e infermierisë dhe të spitalit, si dhe, e) sektorin e bashkëpunorëve të mbrojtur të drejtësisë. Vetëm godinat e banimit kanë kapacitet fizik për 828 persona të dënuar dhe të paraburgosur, mbështetur në urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve nr.735, datë 04.05.2023 “Për miratimin e kapaciteteve të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”.

Në ditën e inspektimit, në mjediset e regjimit të brendshëm **ndodheshin 829 të burgosur**, të ndarë sipas sektorëve:

- 547 persona në sektorin e të paraburgosurve;
- 268 persona dhe sektorin e të dënuarve;
- 8 persona në sektorin e bashkëpunorëve të mbrojtur të drejtësisë;
- 5 të burgosur të shtruar në QSB Tiranë;
- 1 person në sektorin e mbikqyrjes së veçantë.

Situata e popullimit në godinat e banimit për periudhën e fundit 6-mujore, ka qenë si më poshtë vijon:

• Nëntor 2022	-	822 të burgosur (535 të dënuar dhe 287 të p/b)
• Dhjetor 2022	-	798 të burgosur (537 të dënuar dhe 261 të p/b)
• Janar 2023	-	773 të burgosur (512 të dënuar dhe 261 të p/b)
• Shkurt 2023	-	782 të burgosur (522 të dënuar dhe 260 të p/b)
• Mars 2023	-	794 të burgosur (537 të dënuar dhe 257 të p/b)
• Prill 2023	-	805 të burgosur (546 të dënuar dhe 259 të p/b)

Nisur nga statistikat e gjendjes së popullimit në momentin e inspektimit dhe për periudhën 6-mujore, IEVP Fier kishte një situatë të lehtë mbipopullimi në sektorin e të dënuarve dhe sektorin e të paraburgosurve. Avokati i Popullit vlerëson masat e marra nga drejtuesit dhe stafi i institucionit, nëpërmjet një rishpërndarje të drejtë të të burgosurve në godinat e

² Aktualisht, nga informacioni i drejtorit të IEVP-së është plotësuar vendi vakant i mjekut në sektorin e shëndetësisë dhe i specialistit në sektorin e edukimit. Vazhdojnë procedura e konkurimit për plotësimin e vendeve vakante në sektorin e policisë.

banimit, brenda kapacitetit fizik të institucionit, duke garantuar të drejtën themelore të të burgosurve për jetesë normale dhe banim, sipas kushteve dhe kriterëve për sipërfaqen dhe kubaturën e lejuar për person, të përcaktuara në aktet ligjore dhe standardet ndërkombëtare.

Infrastruktura në regjimin e brendshëm të institucionit përbëhet nga 5 godina, të ndara në 3 (tre) godina (A, B dhe C) për akomodimin e personave të dënuar, 1 (një) godinë për të paraburgosurit dhe 1 (një) godinë e ambienteve ndihmëse.

- Godinat e banimit për të dënuarit (A, B dhe C) kanë në total 437 dhoma banimi, të ndara në 389 dhoma dyshe dhe 48 dhoma teke. Godinat janë tre katëshe dhe kanë 6 sektorë, 2 sektorë me 19 dhoma në secilin kat banimi (17 dhoma dyshe dhe 2 dhoma teke). Godinat kanë kapacitet 216 vende secila.
- Godina e p/burgimit ka 108 dhoma banimi, nga të cilat 85 dhoma banimi janë dyshe dhe 23 dhoma janë teke. Godina është tre katëshe, me 2 sektorë me 19 dhoma në secilin kat banimi (17 dhoma dyshe dhe 2 dhoma teke). Për efekt të rishpërndarjes të barabartë të të burgosurve, në katin e parë të godinës A (sektori 1 dhe 2) janë akomoduar gjithashtu të paraburgosur (hyrje të reja) të sapo transferuar nga I EVP Sarandë dhe I EVP Bënc (Tepelenë).
- Sektori për të dënuarit që kanë statusin e bashkëpuntorit të mbrojtur të drejtësisë, ka 13 dhoma teke dhe ndodheshin 8 persona.
- Në secilin sektor ndodhen gjithashtu 6 dhoma (përveç dhomave të banimit) të cilat shërbejnë si ambiente ndihmëse për të burgosurit. Konkretisht: i) ambienti i dushit me 4-5 poste për larjen e trupit me ujë të ngrohtë; ii) palestra me veglat e forcës; iii) klasa për kalimin e kohës së lirë; iv) dhoma e edukimit për punonjësit e sektorit të çështjeve shoqërore ku zhvillojnë me të burgosurit programet individuale të këshillimeve dhe aktivitete me grupe të burgosurish 3-5 persona; v) lavanderia për larjen dhe tharjen e rrobave të të burgosurve; si dhe vi) magazina për ruajtjen e materialeve të çdo sektori.
- Për secilën godinë banimi ka nga 4 bokse ajrimi, nga të cilat njëra është fushë (kalçeto) për zhvillimin e aktiviteteve sportive.

Infrastruktura në godinën e ambienteve ndihmëse, sipas sektorëve, paraqitet si më poshtë vijon:

- Spektori i Kujdesit të Veçantë (SKV), ka 18 dhoma teke. Dhomat janë të kompletuara me krevatë dhe materiale fjetje për një person. Në kohën e inspektimit nuk kishte asnjë pacient të shtruar, me probleme të shëndetit mendor.
- Spektori i infermierisë (spitali), ka 11 dhoma, nga të cilat 8 dhoma teke dhe 3 dhoma dyshe, me kapacitet për 14 persona. Në kohën e inspektimit nuk kishte asnjë pacient të shtruar me rekomandim të mjekut të institucionit. Në mjediset e infermierisë ndodhen gjithashtu dhoma e mjekut, dhoma e infermierisë, dhoma e dentistit, farmacia dhe disa dhoma për mbajtjen e materialeve dhe pajisjeve mjeksore ndihmëse.

- Sektori i observimit, ka 16 dhoma me nga 2 shtretër. Në kohën e inspektimit nuk kishte asnjë të burgosur.
- Sektori i veçimit, ka 6 dhoma me nga 1 shtrat. Në momentin e inspektimit, në këtë ambient ndodhej vetëm 1 person me masë disiplinore “Mbikqyrje e veçantë”.
- Në këtë godinë janë funksionale ambiente si: biblioteka me libra artistik dhe biblioteka me libra fetare, ambientet e kultit (xhamia, kisha ortodokse, kisha ungjillore), dhoma e psikologut, kursi kuzhinës, kursi i anglishtes, klasa e arsimit 9-vjeçar, arshiva e institucionit, etj.

Ambientet e banimit dhe ambientet ndihmëse, në përgjithsi ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjeno-sanitare.

Grupi i inspektimit, verifikoi zbatimin e rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm në IEVP-në Fier, ku rezultoi se, ishin realizuar rekomandimet si më poshtë vijon:

- ✓ Ishte miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, kapaciteti fizik i IEVP-ve me urdhër nr.735, datë 04.05.2023.
- ✓ Institucioni nuk kishte situata mbipopullimi të vazhdueshme në sektorin e të paraburgosurve, pasi ishte bërë një shpërndarje më propocionale e të burgosurve nëpër godinat e banimit, duke respektuar parametrat teknikë dhe jetësor të banimit.
- ✓ Ishin marrë masa për afishimin e posterave me të drejtat e të burgosurve në ambientet e brendshme të sektorëve, si dhe numrave të kontaktit me telefon me Avokatin e Popullit.
- ✓ Në sektorin e shëndetësisë ishte krijuar regjistëri i veçantë, për evidentimin e rasteve që kanë shenja të dukshme në pamjen e jashtme apo dëmtimeve fizike të të burgosurve, të identifikuara nga mjeku në vizitat mjekësore që kryen me pacientët apo gjatë pranimit të hyrjeve të reja në IEVP, së bashku me shpjegimet rreth rrethanave të shkaktuara.
- ✓ Ishte ngritur grup pune me urdhër të brendshëm të drejtorit të IEVP-së Fier, për kontrollin e afatit të skadencave të medikamenteve, nxjerrjen jashtë përdorimit të ilaçeve të skaduar dhe shkatërrimin e tyre, në zbatim të procedurave ligjore.
- ✓ Ishin krijuar palestra në çdo sektor dhe kompletuar me vegla force, për ushtrimin e aktivitetit fizik të të burgosurve, sipas një grafiku të miratuar nga drejtori i institucionit.
- ✓ Në çdo sektor ishin krijuar ambiente më vehte që shërben si lavanderi për larjen e rrobave të të burgosurve dhe tharjen e tyre.

Ndërkohë, disa nga rekomandimet e MKPT-së **nuk** ishin plotësuar, të cilat sipas informacionit, nuk ishin realizuar dhe konkretisht:

- ✓ Nuk ishte miratuar ende Rregullore e Brendshme e IEVP-së Fier, nga DPB.

- ✓ Nuk është miratuar ende udhëzimi i Ministrisë të Drejtësisë për procedurat e dhënies së lejeve shpërblyese të të dënuarve³.
- ✓ Në disa ambiente të katit të parë në godinat e banimit dhe të dusheve, ka ende lagështirë që ndikon në uljen e nivelit të shëndetit të të burgosurve.
- ✓ Institucioni kishte marrë masa për rikonstruksionin e disa ambienteve të dusheve për larjen e trupit të të burgosurve dhe plotësimin me koka dushi të reja, por ende në disa sektorë u konstatua se mungonin koka dushi dhe të burgosurit laheshin në ambientin e dhomave të banimit.
- ✓ Nuk ishte e plotësuar organika e punonjësve të institucionit, pasi kishte vende vakante në stafin civil dhe kryesisht në stafin e policisë.

Pavarësisht disa mangësi të konstatuara nga grupi i inspektimit, Avokatit të Popullit vlerëson se IEVP Fier plotëson kushtet infrastrukturore të nevojshme për jetesë normale të të burgosurve, zhvillimin e aktiviteteve social- kulturore e sportive, si dhe për ushtrimin e aktiviteteve me karakter fetar, sipas llojit të besimit.

Trajtimi i të dënuarve/paraburgosurve

Grupi i inspektimit kishte si qëllim mbledhjen e informacionit lidhur me trajtimin e të burgosurve, për identifikimin e rasteve të përdorimit të dhunës fizike, të torturës, trajtimit degradues e diskriminues, përdorimit të forcës fizike tej kufijve të lejuar apo të presionit psikologjik ndaj tyre.

Nga informacioni i drejtuesve të institucionit dhe nga intervistat konfidenciale të zhvilluara me të burgosurit, grupi i inspektimit nuk evidentoi raste apo pretendime të të burgosurve për ushtrim të dhunës fizike e psikologjike, si dhe tejkallim të forcës fizike nga ana e punonjësve të policisë së burgjeve ndaj tyre.

Lidhur me qëllimin e inspektimit, u verifikua gjithashtu praktika e punës të komisionit për dhënien e masave disiplinore për të burgosurit që kanë kryer shkelje disiplinore. Në dhomat e veçimit të institucionit nuk kishte asnjë të burgosur me masë disiplinore që mund të intervistohet nga grupi i inspektimit, me përjashtim të një të paraburgosuri që ishte vendosur nën regjimin e mbikëqyrjes së veçantë për një periudhë 3 mujore nga IEVP 302, Tiranë⁴. Nga intervistimi, i paraburgosuri nuk shfaqti pakënaqësi për mënyrën e trajtimit nga stafi i IEVP Fier, pasi dhe kushtet e dhomës janë më të përshtatshme në aspektin material dhe atë higjieno-sanitar, krahasuar me IEVP 302. I paraburgosuri nuk ishte dakort me masën disiplinore të dhënë nga drejtori i IEVP-së 302, Tiranë, por dhe për këtë, i paraburgosuri nuk kishte ndjekur shkallët e ankimit të masës disiplinore, sipas procedurave të parashkuara në ligjin nr.81/2020 dhe Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

³ Neni 72, pika 7 e ligjit 81/2020 thuhet shprehimisht se: “Procedurat e dhënies së lejeve shpërblyese përcaktohen me udhëzime të ministrit të Drejtësisë”.

⁴ Neni 68 të ligjit nr.81/2020 thuhet shprehimisht se: “I burgosuri mund të vendoset nën regjimin e mbikëqyrjes së veçantë për një periudhë jo më të gjatë se 3 muaj...Vendosja e të burgosurit në regjimin e mbikëqyrjes së veçantë bëhet me vendim të arsyetuar të drejtorit të institucionit pas marrjes së raportit të vlerësimit nga Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve”

Trajtimi i të burgosurve me masë disiplinore, kryhej në ambiente të përshtatshme të krijuara për këtë qëllim në këtë institucion, si dhe alternimin e masave disiplinore, në përputhje me personalitetin, arsimin, gjendjen social-ekonomike, prirjet dhe aftësitë që ata kanë, duke synuar rehabilitimin për ri-integrimin në jetën familjare, shoqërore dhe ekonomike të tyre.

Pranimi i hyrjeve të reja në institucion dhe trajtimi i tyre, kryhej sipas kërkesave të parashikuara në nenin 38 të ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” dhe Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve. Komisioni i pritjes i ngritur me urdhër të drejtorit të IEVP-së, përbëhet nga përfaqësues i sektorit ligjor, përfaqësues i sektorit të çështjeve shoqërore, përfaqësues i shërbimit shëndetësor dhe një përfaqësues i shërbimit të sigurisë.

Të burgosurit që hynin rishtaz në institucion, sipas intervistave me të burgosurve që ndodheshin në dhomat e observimit, u jepej informacioni i nevojshëm mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, si dhe ishin njohur me rregulloren e institucionit, në formë verbale dhe të shkruar në gjuhën që ata e kuptojnë. Menjëherë pas pranimi në institucion, i burgosuri i nënshtrohet një vizite ekzaminuese dhe interviste mjekësore nga ana e mjekut të institucionit për njohjen e gjendjes shëndetësore fizike dhe psikologjike, me qëllim parandalimin e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse në institucion, vetëvrasjeve, regjistrimin e shenjave të dëmtimeve fizike, që janë shkaktuar jashtë institucionit në kohën e kontrollit. Nga inspektimi i mëparshëm, u evidentua gjithashtu se, në sektorin e shëndetësisë ishte hapur edhe regjistri për regjistrimin e shenjave dhe dëmtimeve fizike, të identifikuar në vizitën e pranimit, së bashku me shpjegimet rreth rrethanave të shkaktuara⁵.

Në intervistat me të burgosurit, u evidentuan ankesa që kishin të bënin me lagështirën në ambientet kryesisht në katet e para të godinave të banimit dhe ambienteve të dusheve. Pavarësisht disa meremetimeve të kryera në këto ambiente me fondet e institucionit, në disa ambiente ende kishte lagështirë. Një nga faktorët e lagështirës, ka të bëjë me faktin se godinat e institucionit janë të ndërtuara në një zonë moçalishte dhe me ujë në gjithë perimetrin e rrethimit të jashtëm. Situata e lagështirës përsëritet sidomos në periudha kur ka rreshje të mëdha të shirave.

Një problematikë tjetër që u evidentua nga ankesat e të dënuarve, kishte të bënte me kufizimin e lejeve shpërblyese, për këtë kategori. Kjo masë kufizuese e vendosur që në periudhën e pandemisë, ende nuk është shfuqizuar, duke shkelur një nga të drejtat e parashikuara në nenin 72 të ligjit 81/2020⁶. Përsa kohë, masat shtërguese të vendosura për shkak të pandemisë COVID-19 ishin shfuqizuar, të dënuarit kërkonin që të hiqej kufizimi edhe për kërkesat për lejet shpërblyese, si një e drejtë e ligjshme e tyre.

⁵ *Neni 38/10 i ligjit 81/2020: “Shenjat e dëmtimeve fizike, të identifikuar në vizitën e pranimit, duhet të regjistrohen në një regjistër të veçantë së bashku me shpjegimet rreth rrethanave të shkaktuara. Nëse ka të dhëna dhe fakte që krijojnë bindjen e arsyeshme se ndaj tij mund të jetë kryer vepër penale, njoftohen organet e procedimit penal në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale”.*

⁶ *Në nenin 72 i ligjit 81/2020 thuhet shprehimisht se: “Të dënuarit, të cilët respektojnë rregullat e disiplinës, rregulloren e brendshme të institucionit, janë të motivuar për të marrë pjesë në programet rehabilituese e të riintegrimit, si dhe nuk paraqesin rrezikshmëri shoqërore, **kanë të drejtë të marrin leje shpërblyese**, por jo më shumë se 20 ditë në vit.”*

Avokati i Popullit vitet e fundit ka rekomanduar në lidhje me zbatimin korrekt të dispozitave të dhënies së lejeve shpërblyese dhe vlerëson se, mungesa e tyre për një kohë të gjatë pas heqjes së çdo mase kufizuese që lidhet me pandeminë për popullsinë e gjërë, është tregues se kjo masë tashmë nuk mund të konsiderohet e arsyeshme. Në këtë kuadër është e nevojshme nxjerrja e udhëzimit të Ministrisë të Drejtësisë⁷, ku përcaktohen procedurat që duhet të ndjekin autoritetet përgjegjëse të sistemit të burgjeve për dhënien e lejeve shpërblyese, në bazë të kërkesave të të dënuarve.

Masat mbrojtëse

Vëmendje të veçantë, grupi i inspektimit i kushtoi edhe funksionimit të sistemit të kërkesë/ankesave të të burgosurve, kqyrjen dhe plotësimin e dokumentacionit ku pasqyrohen veprimet e kryera nga stafi i institucionit, për trajtimin dhe zgjidhjen e tyre.

Nga verifikimi i disa praktikave, rezultoi se, sistemi i kërkesë/ankesave të të burgosurve funksiononte sipas procedurave të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr.81/2020⁸. Kërkesat apo ankesat e të burgosurve pasi regjistrohen në regjistrin përkatës, protokollohen nga sekretaria e institucionit. Regjistri ishte i sekretuar dhe administrohej nga punonjësja e ngarkuar me këtë detyrë.

Të burgosurit pasi plotësonin një formular kërkesë/ankese, ia dorëzonin punonjësit të sektorit të çështjeve shoqërore sipas sektorëve. Punonjësi i këtij sektori brenda ditës i përcillte ato në sekretarinë e institucionit ku protokolloheshin dhe më tej, i kalonin drejtorit të institucionit për adresimin e tyre sipas sektorëve përgjegjës. Kthimi i përgjigjes bëhej me shkrim ose verbalisht në takimet me të burgosurit. Shqyrtimi dhe kthimi i përgjigjes i ankesave dhe kërkesave të të burgosurve, kryhej shpejt dhe jo më vonë se 14 ditë, sipas afatit të përcaktuar në neni 59 të ligjit 81/2020⁹.

Në rastin kur drejtori i institucionit nuk shprehet me vendim për zgjidhjen e kërkesës apo ankesës, të burgosurve, ju lind e drejta të ankohen në rrugë administrative pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni. Kundër vendimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve i burgosuri ka të drejtë t'i drejtohet edhe gjykatës kompetente sipas parashikimeve të nenit 80 të këtij ligji¹⁰.

Në ambientet e regjimit të brendshëm, ishin të vendosura kuti postare për depozitimin e ankesë/kërkesave që të burgosurit ju drejtojnë Avokatit të Popullit apo institucioneve të tjera shtetërore, jashtë sistemit të burgjeve. Njëkohësisht, ky lloj shërbimi ofrohej edhe

⁷ Neni 72, pika 7 e ligjit 81/2020 thuhet shprehimisht se: "Procedurat e dhënies së lejeve shpërblyese përcaktohen me udhëzim të ministrit të Drejtësisë".

⁸ Neni 58 thuhet shprehimisht se: "Çdo institucion mban dhe përditëson regjistrin e kërkesave ose të ankesave të të burgosurve në formë shkresore dhe elektronike. Formatit dhe përmbajtja e regjistrin, si dhe procedura për kthimin e përgjigjes përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të burgjeve".

⁹ Neni 59/1 e ligjit 81/2020 parashikon se: "Organet kompetente, sipas këtij ligji, shqyrtojnë ankesën dhe kërkesën sa më parë, por jo më vonë se 14 ditë nga paraqitja, përveç rasteve kur ky ligj parashikon afate të posaçme për shqyrtimin e tyre".

¹⁰ Neni 80 i ligjit 81/2020: "Kundër vendimit të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale ose të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve mund të bëhet ankim në gjykatën e vendit të ekzekutimit të vendimit penal, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale".

nëpërmjet pagesës së zarfit dhe pullës postare nga vetë i burgosuri, ndërsa dërgimi në postë kryhej nga një prej punonjësve të sektorit të çështjeve shoqërore.

Nga verifikimi i regjistrit të kërkesë/ankesave, për periudhën një vjeçare ishin të regjistruara 6981 kërkesë/ankesa, nga të cilat 467 kërkesa i takonin sektorit juridik për dinamikën e vuajtjes së dënimit, kërkesa për takim me avokatët, transferime në IEVP të tjera etj. Pjesa tjetër konsistonin më së shumti në kërkesa për vizitë te mjeku ose për në spitalin rajonal të Fierit, për takime me familjarë, komunikim me skype, punësim ose kërkesë për blerjen e pajisjeve si TV, frigorifer, etj.

Sistemi i monitorimit me kamerat e sigurisë ishte funksional dhe mban nën vëzhgim ambientet në regjimin e brendshëm dhe të jashtëm të institucionit. Monitorimi i këtyre mjediseve kryhej përgjatë 24 orëve, të dhënat (pamjet) administrohen nga serveri qendror dhe ruhen për një afat kohor deri në 30 ditë.

Të burgosurit komunikonin me telefon me familjarët e tyre, duke kryer 8 telefonata në muaj¹¹, në oraret e parashikuara në programin ditor të veprimtarive miratuar nga drejtori i IEVP-së. Aparatet e telefonave janë të vendosur në korridoret e secilit sektor dhe në ambientet e ajrimit. Ato ishin në gjendje të plotë pune. Të burgosurit ngrinin si problematikë kufizimin e deri në 10 numra telefoni të lejuara nga rrethi familjarë, si dhe për vonesat e krijuara në miratimin e kërkesave për ndryshimin e numrave të telefonave.

Sipas informacionit të drejtuesve të institucionit, rezultoi se, vonesat në miratimin e kërkesave për ndryshimin e numrave të telefonit, ishin për shkak të mungesave në dokumentacionin që vërteton gjeneralitetet e personit që disponon numrin e telefonit dhe jo për mungesë të vullnetit nga drejtuesit e institucionit.

Ambienti i takimeve të të burgosurve me familjarët ndodhet në katin e parë të godinës në hyrje të regjimit të brendshëm. Ambienti përbëhet nga 11 poste për takimin e të burgosurve me familjarët me një ndarje në mes me xham, 6 poste ku janë instaluar kompjutera për takime online, 2 dhoma prindërimi për të burgosurit familjarë, 2 dhoma për takime me prokurorë dhe avokatë mbrojtës, 8 dhoma për takime speciale të të dënuarve familjarë, si dhe disa dhoma që shërbenin për takime të drejtorit të IEVP-së me të burgosurit, dhoma për mbledhjet e komisionit të pritjes, etj.

Nga intervistat me të burgosurit, takimet me familjarët kryheshin rregullisht 4 herë në muaj, nga të cilat 3 takime fizike dhe 1 takim online në muaj nëpërmjet platformës “skype”¹². Ata ngrinin si problematikë dhe kërkonin heqjen e xhamit në postet e takimeve me familjarët, pasi ai nuk lejon ndërveprimin dhe kontaktin fizik me familjarët. Ndërsa, të burgosurit që për arsye të largësisë me familjarët, kërkonin të kryenin më shumë se 1 (një) komunikim me “skype”, aktualisht ju lejohej me miratim të drejtorit të institucionit.

¹¹ *Neni 74 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve*: “Të burgosurit i lejohej 8 (tetë) herë në muaj biseda telefonike me familjarët, të afërmit dhe në raste të veçanta me të tretët, me shpenzimet e tij. Drejtori i institucionit lejon kryerjen e bisedave telefonike shtesë dhe në këtë rast shërbimi telefonik përballohet nga vetë i burgosuri. Bisedat telefonike zhvillohen nën mbikëqyrjen vizuale të personelit”.

¹² *Neni 70, pika 10 e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve*: “Të burgosurit kanë të drejtë të zëvendësojnë 1 (një) vizitë fizike me atë online”.

Veç ambienteve në godinën ku ndodhen postet e takimeve, në një nga hapsirat midis godinave të banimit, është krijuar me ndihmën e financimit të një donatori (Banka RFZB, dega Fier), një mjedis i veçantë për takimin e të burgosurve me familjet dhe fëmijë e tyre. Ky mjedis është i hapur rrethuar nga një lulishte, ku janë vendosur tavolina, karrige dhe lodra për fëmijët, të mbuluara me çadra për tu mbrojtur nga dielli apo dhe shiu.

Grupi i inspektimit evidentoi se, njohja me të drejtat e detyrimet ligjore të të burgosurve në IEVP, si dhe me rregulloren e institucionit, kryhej rregullisht që në momentin e pranimit të të burgosurve në këtë institucion nga komisioni i pritjes, si dhe në kontaktet e vazhdueshme që kanë të burgosurit me punonjesit e sektorit të edukimit. Por, nga inspektimi u evidentua se në korridoret e sektorëve në godinat e banimit, nuk ishin afishuar postera me të drejtat e detyrimet e të burgosurve, nëprmet të cilave ata të njihen me të drejtën ligjore për informim dhe detyrimin e institucionit për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar prej tyre, si dhe posterave për njohjen me misionin e institucionit të Avokatit të Popullit dhe organizatat e shoqërisë civile, që kanë në fokus mbrotjen e të drejtave të të burgosurve.

Numri i të punësuarve sipas organikës të miratuar nga DPB-ja për këtë insitucion, përfshinë 52 të dënuar dhe të paraburgosur. Aktualisht në listë pagesën për muajin prill 2023, ishin përfshirë 46 të burgosur, të punësuar si sanitar, lavanderi, punonjës kuzhine dhe ndarës ushqimi, mirëmbajtës/bojaxhi/marangoz/lulishtar/ngarkim-shkarkim dhe berber, sipas kërkesave të të burgosurve. Institucioni kishte lidhur kontratat e punës me çdo të punësuar, ku përcaktohet lloji i punës, orari i punës dhe masa e shpërblimit financiar për punën e kryer. Të punësuarit nuk ngritën pretendime për kushtet e punës dhe masën e shpërblimit financiar. Por, disa prej tyre ngritën si shqetësim mungesën e kartave të identitetit dhe për rrjedhojë pamundësinë për të hapur numër llogarie në një nga bankat e nivelit të dytë. Sipas informacionit të drejtuesve të institucionit, pjesa më e madhe e tyre kanë deklaruar se kanë humbur kartën e identitetit dhe procedura është e gjatë, pasi duhet deklaruar humbja pranë komisariatit të policisë të vendbanimit të tyre dhe pas përgjigjes nga organi i policisë, të burgosurit i lind e drejta për të aplikuar për kartën e re të identitetit.

Avokati i Popullit vlerëson masat e marra nga DPB-ja dhe IEVP-të për zbatimin e kërkesave të VKM-së nr.602, datë 13.10.2021 “Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj, por nxit ata që të mundësojnë sa më parë infrastrukturën e nevojshme për të burgosurit e punësuar me qëllim pajisjen me karta identiteti, në bashkëpunim me organet e tjera shtetërore.

Kushtet materiale

Grupi i inspektimit, vëmendje të veçantë i kushtoi verifikimit të kushteve infrastrukturore dhe materiale për jetesë të të burgosurve në IEVP Fier, si e drejtë që ju garantohet me aktet kombëtare dhe standardet ndërkombëtare.

Ndërtimi i I EVP Fierit është realizuar në kuadër të programit IPA 2007-2010 dhe është venë në shfrytëzim nga muaji Shkurt i vitit 2015. Infrastruktura në regjimin e brendshëm afron kushte të përshtatshme për akomodimin e të burgosurve, zhvillimin e aktiviteteve kulturore, sportive dhe edukuese, shërbim shëndetësor dhe stomatologjik, asistencë juridike, asistencë psikologjike dhe sociale, kurse të formimit profesional, etj.

Sikurse përmendëm edhe më lart, godinat e banimit janë të ndara sipas statusit të të burgosurve, 1(një) godinë për të paraburgosurit dhe 3(tre) godina për të dënuarit. Për secilën godinë banimi, ka bokse ajrimi dhe fushë sporti (kalceto) për zhvillimin e aktiviteteve sportive.

Gjatë inspektimit u konstatua se, dhomat e banimit ishin të kompletuara me krevatë për fjetje, tavolinë dhe karrige për qëndrimin ulur dhe me tualete brenda tyre. Të burgosurit ishin të furnizuar me materiale për fjetje si dyshekë, jastek, çarçafë dhe batanije. Dhomat e banimit kanë sipërfaqe dhe kubaturë të mjaftueshme për akomodimin deri dy persona në dhomë. Në asnjë nga dhomat e banimit nuk u gjetën persona të akomoduar mbi kapacitetin e dhomës. Dritaret e dhomave kanë përmasa të tilla që lejojnë depërtimin e ajrit dhe dritës natyrale. Ambientet e banimit, ambientet ndihmëse dhe ambientet e përbashkëta kishin ndriçim artificial që furnizohet nga rrjeti elektrik. Në rast ndërprerje të energjisë elektrike apo të difekteve në rrjetin elektrik, institucioni kishte gjenerator për secilën godinë, që shërben si burim rezervë për furnizimin me energji elektrike.

Larja e materialeve të fjetjes dhe rrobave personale kryhej në lavanderinë e ndërtuar në çdo sektor. Dhomat e lavanderisë ishin të kompletuar me lavatriçe, ndërsa për tharjen e rrobave ishin krijuar gjithashtu ambiente më vehte brenda secilit sektor.

Ambienti i dushit për larjen e trupit, ishte i përbashkët për të burgosurit në bazë sektori. Në këtë ambient kishte 4-6 poste për larjen e trupit për të burgosurit, por në sektorët e paraburgimit, u konstatuan mungesa të kokave të dusheve ose dhe koka dushi të dëmtuara.

Ambienti i dhomave të banimit, koridoret e përbashkëta, dushet dhe klasat ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjeno-sanitare, me përjashtim të ambINETEVE të katit të parë në godinën e të paraburgosurve ku u evidentua se, në këto ambiente kishte lagështirë dhe nuk ishin të mirëmbajtura.

Në çdo sektor ishin krijuar dhoma që shërbenin si palestër, të cilat përgjithësisht ishin të kompletuara me pajisje dhe vegla force. Ambiente që shërbenin për palestër kishte edhe në godinën e të paraburgosurve, por ato nuk ishin të kompletuara me vegla force dhe të paraburgosurit kishin sajuar disa pajisje force me mjete rrethore. Qëndrimi në palestër kryhej sipas orarit të veprimeve të miratuar nga drejtori dhe shefi i policisë në këtë institucion.

Klasat e edukimit në çdo sektor u shërbejnë punonjësve të sektorit të çështjeve shoqërore për takime me të dënuarit dhe të paraburgosurit në rastin e marrjes së kërkesë/ankesave, për trajtime individuale psiko-sociale sipas programeve të miratuara, si dhe takime me

grupe të vogla të burgosurish. Në këto ambiente, sipas orarit të veprimeve, zhvillohen gjithashtu dhe lojra tavoline nga të burgosurit në bazë sektori.

Çdo sektor ka holle në korridorin e përbashkët, të pajisur me tavolina dhe stola të gjatë për qëndrimin ulur (me këmbë të fiksuara në dysHEME), ku të burgosurit sipas grafikut të miratuar nga sektori i policisë, mund të qëndrojnë pas orarit të ajrimit, me grupe të vogla për kalimin e kohës së lirë.

Furnizimi me produkte ushqimore dhe industriale për nevoja personale të të burgosurve, kryhej rregullisht përmes marketit “online” që funksionon për gjithë sistemin e burgjeve. Lista me çmimet e produkteve ndodhet online në faqen e këtij marketi, por ishte e afishuar dhe në hollin e korridoreve për secilin sektor. Të burgosurit i paraqitën ankesa grupit të inspektimit në lidhje me çmimet e larta të produkteve ushqimore. Ankesa u paraqitën gjithashtu dhe për porositë e ushqimit, të cilat në shumicën e rasteve, nuk ishin të njëjta me porositë online të bëra nga të burgosurit. Pavarësisht ankesave, të burgosurit e konsideronin njësinë tregtare, si mundësi për të plotësuar nevojat e tyre, të cilat nuk u mundësohen nga institucioni.

Kuzhina e institucionit ishte në kushte shumë të mira funksionale, me ambiente më vehte të ndara për gatim, vendosjen e frigoriferëve, ruajtjen e produkteve ushqimore, si dhe larjen e enëve. Ajo ishte e kompletuar me pajisjet e gatimit dhe sistemin e aspirimit, sipas standardeve industriale. Stafi i kuzhinës ishte i plotësuar sipas organikës, 5 (pesë) kuzhinierë dhe 10 nd/kuzhiner nga lista e të burgosur të punësuar.

Në kuzhinë ndodhej e afishuar menuja javore e gatimit të ushqimit dhe tabela me normativat e produkteve ushqimore. Kampionët e ushqimit ruhen në frigorifer, të ndarë sipas vakteve të ushqimit. Regjistrat e kontrollit të ushqimit dhe të menisë së gatimit ishin të sekretuar dhe të protokolluar.

Gatimi i ushqimit për të burgosurit ishte me cilësi të mirë dhe i mjaftueshëm, i përshtatshëm për moshën, gjendjen shëndetësore, natyrën e punës, kushtet klimaterike, besimin fetar dhe nevojat e veçanta të tij. Në momentin e inspektimit gatuhej më vehte për 36 persona të sëmurë diabetik. Pajisjet e përgatitjes dhe gatimit të ushqimit në kuzhinë, si dhe shpërndarja e tyre nëpër dhoma, ishin të reja dhe në gjendje të mirë.

Pavarësisht kushteve të mira në kuzhinë, disa të burgosur deklarorin se merrnin ushqimin nga familjarët e tyre dhe gatuanin në dhoma, duke mos e konsumuar ushqimin e institucionit, për shkak të mungesës së larmishmërisë së tij.

Regjimi dhe aktivitetet

Aktiviteti dhe veprimtaritë ditore me të burgosurit në IEVP Fier, ishin të organizuar sipas orarit ditor të miratuar nga drejtori i institucionit. Aktiviteti kryesor që zhvillohej me të burgosurit jashtë ambientit të qelive, ishte ajrimi i cili kryhej rregullisht çdo ditë sipas orareve të përcaktuara në rregulloren e përgjithshme të burgjeve dhe i ndarë sipas

stinëve¹³. Ambientet e ajrimit dhe fushat kalçeto janë të ndara më vehte për secilën godinë banimi. Nga pikpamja e ndërtimit, e hapsirës dhe gjatësisë që kanë, vendet e ajrimit plotësojnë kushtet për ajrim dhe të sigurisë për të burgosurit.

Aktivitetet me karakter kulturor dhe sportiv, me pjesmarrjen e gjerë të të burgosurve sipas sektorëve, zhvilloheshin në bazë të programit të miratuar nga drejtori i institucionit dhe shefi i policisë, nën mbikqyrjen e punonjësve të sektorit të çështjeve shoqërore dhe punonjësve të sigurisë në regjimin e brendshëm. Pavarësisht programeve, të burgosurit ngrinin shqetësimin se duhen të organizohen aktivitete të larmishme me karakter edukativ, kulturore dhe sportive dhe me pjesmarrjen e të burgosurve sipas godinave. Aktivitetet e vetme që zhvilloheshin në ajrim ishin aktivitetet në rastin e festave kombëtare apo festave fetare, si dhe lojërat e tavolinës dhe ndeshjet e futbollit në kalçeto. Në klasat e edukimit zhvillohen programet individuale të këshillimeve dhe në grupe të vogla me të burgosurit.

Larmia e aktiviteteve dhe pjesmarrja e gjerë e të burgosurve, ndikojnë jo vetëm në mardhëniet midis të burgosurve dhe socializimin e tyre, por është dhe një nga detyrimet e institucioneve penitenciare, me qëllim rehabilitimin dhe ri-integrimin e të burgosurve, në momentin kur ata përfundojnë kohën e vuajtjes së dënimit. Për këtë qëllim, edhe Rregullorja Evropiane e Burgjeve parashikon qartazi se: *“regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit përfshin një program të balancuar veprimtarish. Ky regjim u lejon të gjithë të burgosurve të kalojnë sa më shumë orë në ditë jashtë qelive të tyre, sipas nevojës për një nivel të përshtatshëm të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror”*¹⁴.

Në këtë kuadër, Avokati i Popullit vlerëson masat e marra nga sektorët e çështjeve shoqërore në planifikimin dhe organizimin e aktiviteteve që ndikojnë në qëndrueshmërinë psiko-sociale të të burgosurve, por sygjeron trajnimin e vazhdueshëm të këtyre punonjësve, me qëllim ngritjen profesionale të tyre dhe përdorimin e teknikave të reja në këshillimet individuale dhe në grup me të burgosurit, kryesisht atyre që kanë probleme të shëndetit mendor.

IEVP Fier ka një bashkëpunim të mirë me Qendrën e Formimit Profesional në Fier, në organizimin e kurseve profesionale 3-mujore. Nga informacioni, në këtë institucion ishin efektiv disa kurse si kursi për *“saldim”* me 14 të burgosur; 2 kurse për *“kuzhinë”* me 15 të burgosur për secilin kurs; 2 kurse për *“rrobaqepsi”* me nga 20 të burgosur dhe ishin në projekt për hapjen edhe të kurseve për mësimin e gjuhëve të huaja. Kërkesat për zhvillimin e kurseve profesionale nga të burgosurit janë të shumta, por QFP Fier nuk ka kapacitetet e nevojshme për sigurimin e instruktorëve sipas kërkesave të këtij institucioni.

Gjithashtu, në bashkëpunim me zyrën vendore arsimore Fier, në këtë institucion zhvillohej një klasë mësimi e nivelit 9-vjeçar me 17 të burgosur. Ky program bashkëpunimi, ka filluar të zbatohet në bazë të një marrëveshje që ky institucion ka me ZVA Fier që nga viti 2018. Avokati i Popullit vlerëson përmirësimin e situatës të aktiviteteve në këtë IEVP dhe

¹³ Neni 37 i ligjit nr.81/2020

¹⁴ Rregullorja e Evropiane e Burgjeve Pika25.1 dhe 25.2;

<http://www.coe.int/t/DGHL/STANDARDSETTING/PRISONS/EPR/EPR-Albanian.pdf>

shpreh bindjen se një gjë e tillë ndikon thelbësisht në realizimin e funksionit integruar të sistemit penitenciar në Shqipëri.

Nga verifikimi i dosjeve psiko-sociale për çdo të dënuar dhe të paraburgosur, u evidentua se ato ishin të plotësuara në rregull, me përmbledhjet nga takimet e fundit me të dënuarin apo të paraburgosurin, vlerësimet e kryera nga punonjësi i edukimit sipas 3 mujoreve dhe gjithë dokumentet e tjera mbështetëse.

Bibloteka dhe klasat e edukimit të institucionit, ishin të kompletuara me libra nga DPB-ja, por dhe nga sponsorizime të donatorëve nga qyteti i Fierit. Disa të burgosur, që ishin dhe frekuentues të leximit të librave, ngritën si nevojë përditësimin e bibliotekës me tituj të rinj të librave, si dhe domosdoshmërinë e organizimit të sa më shumë aktiviteteve në bibliotekë si takime me shkrimtarë, recesione të librave, etj., me qëllim nxitjen e interesit të të burgosurve për librin. Nga pikpamja e administrimit, librat në bibliotekë vihen në dispozicion të të burgosurve sipas kërkesave të tyre, nga punonjësi i sektorit të çështjeve shoqërore, ku për secilin prej tyre ishte hapur kartelë personale me shënimet përkatëse mbi marrjen dhe dorëzimin e librave në bibliotekë.

Shërbimi Shëndetësor

Shërbimi shëndetësor në këtë institucion, përgjithësisht ishte i kompletuar me staf sipas strukturës organike të miratuar për këtë institucion, si dhe është i plotësuar me ambientet e nevojshme në funksion të këtij shërbimi.

Organika e shërbimit shëndetësor përbëhet nga 16 punonjës, nga të cilët 2 janë mjek të përgjithshëm, 1 mjek psikiatër, 1 farmacist, 1 stomatolog, 1 kryeinfermier dhe 10 (dhjetë) infermierë. Mjeku i përgjithshëm (shefi i shërbimit) është i punësuar me kohë të plotë, ndërsa 2 mjekët e tjerë (mjeku psikiatër dhe mjeku i përgjithshëm) janë të punësuar me kontratë me kohë të pjesëshme. Stafit tjetër shëndetësor është i punësuar me kohë të plotë.

U evidentua se, të burgosurit me probleme shëndetësore i drejtonin kërkesë drejtorit të institucionit dhe pas miratimit të kërkesës, ata kryenin vizita mjekësore në ambientet e spitalit të institucionit nga stafi i mjekëve. Krahas vizitave mjekësore nga mjekët e institucionit, trajtimi i të sëmurëve kronikë dhe i rasteve urgjente, me rekomandim të mjekut, të burgosurit shoqëroheshin për vizita mjekësore pranë mjekëve specialistë të Spitalit Rajonal Fier dhe në IVSHB (Spitalin e Burgjeve) në Tiranë.

Sikurse përmendëm më lart, IEVP Fier ka ambient më vehte që shërben si spital, i pajisur me dhoma për personelin shëndetësor dhe dhoma për shtrimin e sëmurëve, sipas rekomandimit të mjekëve të institucionit. Shërbimi shëndetësor ishte funksional dhe i organizuar përgjatë 24 orëve. Në këtë mjedis ndodhen 11 dhoma shtrimi, dhoma e vizitave të mjekut, dhoma e stomatologut, ambienti i farmacisë të institucionit, si dhe disa dhoma të tjera që shërbenin si ambiente ndihmëse për personelin shëndetësor. Në momentin e inspektimit nuk ndodhej asnjë pacient i shtruar në dhomat e spitalit.

Në regjimin e brendshëm ndodhet edhe Sektori i Kujdesit të Veçantë (SKV) me 18 dhoma dhe në momentin e inspektimit nuk kishte asnjë pacient të shtruar me probleme të shëndetit mendor.

Dhomat e shtrimit në spital dhe në SKV janë të kompletuara me materialet e fjetjes, tualete brenda në çdo dhomë, si dhe ambient dushi më vehte. Dhoma e mjekut, farmacistit dhe dhoma e urgjencave ishin të kompletuara me të gjitha orenditë dhe pajisjet e nevojshme (rafte, tavolina pune, karrige, si dhe shtrat për kryerjen e vizitave mjeksore), që nevojiten për ndjekjen e protokollit shëndetësor për të sëmurët kronikë ashtu edhe për rastet e urgjencave. Gjithashtu edhe dhoma e stomatologut ishte e kompletuar me sterilizues, karrige dhe unit (poltroni) funksional.

Në katin e parë të secilës godinë banimi ka nga një dhomë për infermierët e turnit, të cilat kanë hapësirë e sipërfaqe të vogël, por me kushte të mira higjierno-sanitare. Në këtë ambient, infermierët mbanin një sasi të vogël të ilaçeve për rastet e urgjencave. Për shoqërimin e të sëmurëve në rastin e vizitave mjeksore apo të urgjencave për në spitalin e Fierit, IEVP Fier ka në dispozicion një automjet ambulancë të re. Avokati i Popullit vlerëson përpjekjet e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, për rinovimin e autoambulancave të cilat janë shumë të rëndësishme për të garantuar jetën dhe shëndetin e të burgosurve.

Furnizimi me ilaçe i institucionit për të sëmurët kronikë, funksiononte rregullisht sipas skemës së ribursimit mes FDSKSH-IEVP-Depo farmaceutike. Nga intervistat e pacientëve me sëmundje kronike, u ngrit si shqetësim mungesa në listën e rimbursimeve e disa medikamenteve që përdoren nga ana e tyre (sipas emërtimeve), ndaj në këto kushte ata vijonin të merrnin ilaçet nga familjarët e tyre.

Në rastet e pacientëve me sëmundje patologjike dhe të urgjencave, furnizimi me medikamente kryhej normalisht nga farmacisti i institucionit. Farmacia e institucionit, furnizohej me medikamente rregullisht 2 herë në vit nga DPB-ja, ndërsa për nevoja urgjente, institucioni ka në dispozicion një fond të veçantë në buxhet për blerjen e medikamenteve. Shpërndarja e ilaçeve për të sëmurët sipas kategorive, kryhej nga personeli i infermierëve sipas turneve të shërbimit 24 orë, na bazë të rekomandimit të mjekut të institucionit.

Për nxjerrjen jashtë përdorimit të medikamenteve, që kanë kaluar afatin e skadencës, drejtori i institucionit në bashkëpunim me sektorin e shëndetësisë, kishin ngritur një grup pune për kontrollin e skadencave të medikamenteve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të tyre, sipas procedurave ligjore për shkatërrimin e tyre.

Në kohën në të cilën u krye inspektimi në IEVP Fier, kishte ndodhur një ngjarje me pasojë vdekjen e shtetasit S.T në datë 04.05.2023, i cili vuante dënimin në këtë institucion. Institucioni i Avokatit të Popullit, për zbardhjen e kësaj ngjarje të rëndë, është duke kryer një hetim administrativ paralelisht me hetimin penal që ka filluar menjëherë organi i Prokurorisë të Rrethit Gjyqësor Fier. Rezultatet e këtij hetimi do t'ju bëhen të njohura nga institucioni ynë, në përfundim të procedurave të këtij hetimi. Por, paraprakisht sjellim në

vëmendjen tuaj faktin se, pavarësisht mundësive dhe përpjekjeve që stafi shëndetësor dhe drejtuesit e institucionit kanë bërë dhe bëjnë çdo ditë për ruajtjen dhe sigurinë e shëndetit të të burgosurve, referuar rastit të lartpërmendur, në vlerësimin e institucionit të Avokatit të Popullit, funksionimi i sistemit shëndetësor në IEVP, duhet të jetë në nivelin e standardeve ndërkombëtare e përcaktuar qartë në Rregulloren Evropiane të Burgjeve, ku thuhet shprehimisht se: *“Autoritetet e burgut ruajnë shëndetin e të gjithë të burgosurve që janë në kujdesin e tyre. Shërbimet mjekësore në burg organizohen në bashkëpunim të ngushtë me administrimin shëndetësor të komunitetit ose të shtetit. Të burgosurit i ofrohen shërbimet mjekësore, kirurgjike dhe psikiatrike, duke përfshirë dhe ato shërbime që janë të disponueshme në komunitet”*¹⁵.

Nga kqyrja e dokumentacionit që administrohet nga stafit mjekësor, u evidentua se ka regjistër të vizitave mjekësore, regjistër të të sëmurëve kronike, si dhe regjistër për konsultat dhe vizitat mjekësore në Spitalin Rajonal Fier. Gjithashtu, në dhomën e mjekut ndodhej dhe regjistri i veçantë për regjistrimin e rasteve të dhunës apo të dëmtimeve fizike të identifikuara në vizitën e pranimit të të burgosurve që hyn rishitaz në këtë institucion, sipas parashikimeve ligjore¹⁶.

Protokollet shëndetësore dhe regjistrat e shërbimit 24 orë të infermierëve, ishin të protokolluara në sekretari, ishin të plotësuar sipas rubrikave dhe ishin mbajtur në rregull.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, ku parashikohet midis të tjerash se: *“Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca: b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues.”*

REKOMANDOJMË:

1. Të merren masa e menjëhershme nga DPB, për miratimin e Rregullores së Brendshme të IEVP-së Fier.

¹⁵ Rregullorja Evropiane e Burgjeve, pika 39, 40.1, 40.5;

¹⁶ Neni 38, pika 10 e ligjit 81/2020: *“Sbenjat e dëmtimeve fizike, të identifikuara në vizitën e pranimit, duhet të regjistrohen në një regjistër të veçantë së bashku me shpjegimet rreth rrethanave të shkaktuara”*.

2. Të merren masat e nevojshme, për nxjerrjen e udhëzimit ku të përcaktohen procedurat që duhet të ndjekin drejtoritë e IEVP-ve dhe DPB-ja, në rastin e kërkesave të të dënuarve, për të përfituar lejen shpërblyese¹⁷.
3. Të merren masat e nevojshme, për plotësimin e vendeve vakante në organikën e institucionit, kryesisht në stafin civil me mjek të përgjithshëm, infermierë dhe punonjës edukimi, si dhe në stafin e policisë (56 vende vakante), për të garantuar shërbimet e nevojshme dhe sigurinë ndaj të burgosurve që vuajnë dënimin në këtë institucion.
4. Të merren masa të menjëhershme, për afishimin në ambientet e brendshme të sektorëve të posterit me të drejtat e të burgosurve, si dhe për rolin e Avokatit të Popullit dhe OJF-ve që veprojnë në fushën e mbrojtjes të të drejtave të të burgosurve, për trajtimin dhe zgjidhjen e kërkesë/ankesave të të burgosurve.
5. Të merren masat e nevojshme për trajnimin e vazhdueshëm të stafit psiko-social të IEVP-së, me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale të tyre, në trajtimin e të burgosurve, kryesisht atyre me probleme të shëndetit mendor, sipas programeve psikoterapeutike.
6. Të merren masat e nevojshme, për eliminimin e lagështirës në godinën e të paraburgosurve dhe ambientet e dusheve në regjimin e brendshëm, pasi ndikon në përkeqësimin e shëndetit të të burgosurve.
7. Të merren masa të menjëhershme, për rikonstruksionin e ambienteve të dusheve në sektorin e paraburgimit dhe kompletimin me koka dushi të reja.
8. Të merren masat e nevojshme nga sektori i çështjeve shoqërore, për organizimin e aktiviteteve të larmishme me pjesmarrjen e gjerë të të burgosurve.
9. Të merren masa të menjëhershme, për kompletimin e bibliotekës së institucionit me tituj të rinj të librave.
10. Të merren masa të menjëhershme, për përmirësimin e menisë javore në kuzhinën e institucionit, miratuar nga drejtori i institucionit, me qëllim larmishmërinë në gatimin e ushqimit për të burgosurit.
11. Të kontrollohet në vijëmbësi funksionimi i furnizimit ushqimor të të burgosurve, për të mos patur parregullsi.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

¹⁷Neni 72, pika 7 e ligjit 81/2020 thuhet shprehimisht se: “Procedurat e dhënies së lejeve shpërblyese përcaktohen me udhëzime të ministrit të Drejtësisë”.

KOMISIONERI

Ahmet PRENÇI